

Intervistë me Helena Kontkanen, Ombudsman i Falimentimit i Finlandës



Përveç ligjit edhe rrethanat tjera - si rekomandimet, këshillimet dhe ndikimi i fituar - janë pjesë e mozaikut të suksesit

Gjatë Projektit për përmirësimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të kompanive janë realizuar dy vizita studimore (në Finlandë dhe Slloveni), me qëllim shkëmbimin e informacioneve mbi legjislacionin ekzistues për procedurat e falimentimit, funksionimin e tyre në praktikë, si dhe për të parë mundësitë për përmirësim të mëtejshëm të legjislacionit maqedonas, në përputhje me praktikën e mira evropiane. Vizita e dytë studimore u realizua në Finlandë, në Helsinki, ku për 22 vjet funksionon Ombudsmani i Falimentimit.

Duke pasur parasysh se institucioni i Ombudsman i Falimentimit është në shumë mënyra i veçantë dhe se ai është i integruar me shumë sukses në kornizën ligjore finlandeze për insolvencë, njohja me autorizimet, përgjegjësitë dhe aktivitetet e Ombudsmanit të Falimentimit shkaktuan interesim të madh në mesin e anëtarëve të delegacionit të Projektit. Përkatësisht, menaxhimin e procedimeve dhe procedurave të falimentimit në Finlandë e mbikëqyr Ombudsmani i Falimentimit si një organ i posaçëm, i pavarur. Ombudsmani i Falimentimit, në kuptimin ekonomik dhe organizativ është i vendosur në Ministrinë e Drejtësisë. Ombudsmani është i paanshëm dhe neutral në veprimet e tij dhe nuk përfaqëson interesat e ndonjë grupi të caktuar, si kreditorët apo debitorët.

Në kuadër të Projektit, më 25 dhe 26 shtator të vitit 2017, u organizua Konferenca e parë ndërkombëtare për falimentim ku u prezantuan trupat rregullatorë nga pesë vende të ndryshme të cilët rregullojnë procedurën e falimentimit. Në mesin e përfaqësuesve të pranishëm ekspertë vendas dhe ndërkombëtar interes dhe vëmendje më të madhe ngjalli fjalimi i Helena Kontkanen, Avokat i Popullit për falimentim (Avokat i Falimentimit) i Finlandës.

Ekspertët e Maqedonisë e vlerësuan këtë model si më të përshtatshmin për zhvillimin e mëtejshëm të legjislacionit në Maqedoni.

Qëndrimin në Shkup dhe pjesëmarrjen në punën e Konferencës e shfrytëzuam për një intervistë të shkurtër me Znj. Kontkanen.

E nderuara znj. Kontkanen, Finlanda ka zgjidhje specifike ligjore dhe rezultate mbrsëlënëse në fushën e falimentimit. Disa prej tyre u paraqitën gjatë prezantimit tuaj në Konferencë. Cilat ishin motivet, arsyet dhe shkaqet për këtë dhe si është i organizuar Ombudsmeni në Finlandë?

Finlanda ka Avokatin e Popullit për Falimentim për 22 vjet. Në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, kur filluan ndryshimet ligjore që çonin deri te formimi i Avokatit të Popullit për Falimentim, Finlanda pati probleme të shumta ekonomike dhe sociale. Ekonomia ishte në depresion, firmat falimentonin për çdo ditë dhe shumë njerëz mbeteshin pa punë. E gjithë kjo rezultoi me një shkallë të lartë të papunësisë.

Përkatësisht, ka pasur edhe një aktivitet të reduktuar të kreditorëve publikë si rezultat i heqjes së prioriteteve. Mungesa e kontrollit dhe shqyrtimit të procedurave dhe mungesa e kontrollit adekuat mbi aktivitetet e administratorëve të falimentimit, krijoi hapësirë për shfaqjen e abuzimit dhe kimit. Një situatë e tillë imponoi pyetjen se çfarë duhet bërë më tutje, gjegjësisht çfarë duhet ndërmarrë. Propozimi për formimin e Avokatit të Popullit për falimentim është iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, në departamentin ku edhe u përgatit projektligji për insolvencë. U bë një propozim për të krijuar një zyrë të vogël dhe efikase që do të merret me çështjen e procedimeve të falimentimit. Paralelisht, u iniciua edhe krijimi i një Bordi Këshillimor për çështjet e falimentimit.

Na tregoni diçka më tepër për rolin dhe detyrat e Ombudsmanit të Falimentimit...

Mendoj se krijimi i Avokatit të Popullit për Falimentimin dhe Bordit Këshillimor është i një rëndësie të madhe dhe se kjo ka krijuar parakushte themelore për ndryshimin e situatës në atë kohë, si dhe për marrjen e vendimeve përkatëse në mënyrë të përbashkët. Këtu, mbi të gjitha, vihet në dukje qëndrueshmëria dhe përkushtimi ynë në punë, duke filluar nga kontrollimi i procedurave të falimentimit, monitorimi i punës së administratorëve të falimentimit, e deri te rekomandimet që së bashku me Bordin i definojmë dhe dorëzojmë, së bashku me planet për hapat e ardhshëm.

Konsideroj se lidhja dhe kushtëzimi në punën e përbashkët me Bordin, të përcaktuara edhe me dispozitat ligjore, kanë bërë punën tonë të rëndësishme dhe kanë kontribuar për suksesin e arritur. Sigurisht - edhe përkushtimi. Kur ne shënuam njëzetvjetorin e punës sonë, një profesor i shquar pati një prezantim në seminarin që organizuam, i cili pyetjes se – çfarë statusi mund t'u jepet rekomandimeve të Bordit Këshillimor në interpretimet ligjore dhe vendimmarrje - iu përgjigj duke thënë se rekomandimet janë burim legjitim ligjor i cili mund të përdoret si një pjesë e enigmës.

Kjo deklaratë ishte shumë e rëndësishme për ne, sepse vetë Bordi Këshillimor, përfaqësuesit e palëve të interesuara dhe fuqia për të definuar rekomandimet janë pjesë e rregullores. Në njëfarë mënyre, ju mund ta zgjeroni atë në mënyrë që të konfirmoni se jo vetëm ligji, por edhe rrethana të tjera - si rekomandimet, këshillimet, monitorimet, ndikimi i fituar - kanë të gjithë ndikimin e vet dhe janë pjesë e një storjeje të suksesshme për enigmën e suksesit.

Siç thatë, parimet themelore të Ombudsmanit të Falimentimit janë pavarësia, paanshmëria dhe ndikimi, së bashku me përpjekjet e vazhdueshme për përmirësim. Cilat janë burimet e financimit të Avokatit të Popullit për Falimentim?

Ombudsmani i Falimentimit dhe Bordi janë trupa të pavarur, në suaza të Ministrisë së Drejtësisë, jemi të pavarur. Çdo vjeshtë, me ministrinë rumbullakësojmë kornizën financiare për punën tonë në vitin e ardhshëm, bazuar në planet e përcaktuara të punës. Ne financohemi nga buxheti i shtetit.

Për shembull, për vitin e ardhshëm 2018, ne planifikojmë t'i drejtojmë aktivitetet kryesore drejt procedurave tanimë të përfunduara të falimentimit. Pasi të dakordohemi me ministrin rreth aktiviteteve kornizë dhe buxhetit, ne gjithashtu marrim detyrimin për të realizuar gjithçka dhe për të informuar për rezultatet. Kjo do të thotë që ne jemi të pavarur në punën tonë, por sigurisht përgjegjës për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara.

Përveç pavarësisë, ndikimi që ne kemi është i një rëndësie të madhe, në përputhje me mundësitë e parashikuara me ligj. Bëhet fjalë për mundësinë e monitorimit dhe kontrollit të vazhdueshëm të çdo faze të çdo procedure të falimentimit, të çdo administratori të falimentimit, të të gjitha llogarive dhe dokumenteve të tjera që janë me rëndësi për ne dhe për të shqyrtuar rastin. Përveç kësaj, sipas ligjit, bankat janë të detyruara të na japin të gjitha të dhënat lidhur me llogaritë e debitorëve pa kompensim, dua të përmendim se shumatat nuk janë të vogla për këto të dhëna.

E gjithë kjo kontribuoi që Ombudsmani i Falimentimit të fitojë ndikimin e nevojshëm për ekzekutimin e lirshëm dhe vendimmarrjen e duhur në punën e tij. Në të vërtetë, të gjithë janë të vetëdijshëm për mundësitë tona dhe autorizimet tona, kështu që nuk ka nevojë ta demonstrojmë këtë.

Rreth 500 avokatë në Finlandë punojnë me procedurat e falimentimit dhe riorganizimit, por vetëm rreth njëqind janë aktiv, administratorë të falimentimit me kohë të plotë. Shumica e tyre janë avokatë. Ne nuk kemi licencim, e as profesion si administrator falimentimi. Unë mund të them se në sajë të trajnimit të vazhdueshëm pa pagesë, kemi arritur të krijojmë stafin profesional, kur është fjala për procedurat e falimentimit dhe për riorganizimin. Në rastin e riorganizimit gjysma e procedurave janë të pasuksesshme - mendoj se kjo varet nga shumë faktorë por arsyeja kryesore duket të jetë se debitorët shumë vonë hyjnë në procesin e riorganizimit. Edhe pse nuk është e zakonshme që të fajësohet administratori, ka dallime ndërmjet rezultateve të fituara. Përveç aftësive ligjore dhe ekonomike, nevojiten edhe aftësitë personale. Gjithçka ka ndikimin e vet.

Çfarë imazhi kanë administratorët e falimentimit në publik në Finlandë

Njerëzit që punojnë me ne në procedurat e falimentimit dhe në riorganizime e duan punën e tyre. Ne jemi kryesisht juristë. Kur një kompani më e madhe falimenton ose kalon përmes riorganizimit, atëherë ajo tërheq vëmendjen e publikut dhe është në fokus të mediave. Një pjesë e punës sonë është t'u shërbejmë mediave, me fakte dhe detaje të vërteta rreth procedurave të falimentimit ose riorganizimit.

Sidomos në të kaluarën, ka pasur shpesh biseda rreth administratorëve të falimentimit si disa që morën gjithçka dhe nuk lanë asgjë për kreditorët. Veprimet tona kanë ndikuar që të ketë më pak gjëra të tilla. Flitet ende për sasi të larta që marrin administratorët. Ne po mundohemi që përmes këtyre kontrolleve dhe rekomandimeve t'i bëjmë këto shuma të arsyeshme. Administratori meriton një pagesë të drejtë dhe të arsyeshme, në çdo rast, sipas punës që ai ka kryer.

Le të kthehemi te kompetencat e Avokatit të Popullit për Falimentim - së pari, të drejtën për informacion gjithëpërfshirës, dhe së dyti - raportin deri te gjykata për shqiptimin e një gjobe për administratorët e falimentimit të cilët kanë lënë pas dore detyrat e tyre, duke sfiduar të drejtën për kompensim për shkak të neglizhimit të detyrave ose shkaqeve të tjera (të rënda), si dhe reduktimin e kompensimit për shkak të neglizhencës thelbësore të detyrave, ose, nëse tarifa është qartazi mbi një nivel të arsyeshëm.

Legjislacioni maqedonas në fushën e falimentimit përballet me ndryshime të reja. Cilat parime do t'i rekomandonit?

Me sa arrita të kuptoj, rekomandimet e Projektit dhe përfundimet nga kjo konferencë do t'i ofrohen grupit punues të Ministrisë së Ekonomisë e cila do të duhet t'i drejtojë aktivitetet e ardhshme. Secili vend duhet të gjejë rrugën e vet, duke u bazuar në traditën, mentalitetin dhe kornizën legjislative kombëtare. Besoj se propozimet e tyre do të jenë në rrugën e parimeve evropiane dhe rregullativave të miratuara. Përfaqësuesit e disa institucioneve relevante në kuadër të Projektit kishin mundësi gjatë vizitës studimore në Finlandë që të njoftohen me rregulloret ligjore dhe punën e Avokatit të Popullit për falimentim dhe të Bordit. Për organizimin dhe aktivitetet e tyre, fola edhe në Konferencë ku jam duke marrë pjesë me ftesë të Projektit.

Pra, mendoj se duhet të vazhdojë komunikimi i vendosur dhe nëse pikëpamjet tuaja mbi drejtimin e ndryshimeve ligjore përfshijnë krijimin e trupave të njëjtë ose të ngjashëm me Avokatin tonë të Popullit, ne mund të angazhohemi në atë proces. Nëse sigurohet financimi, një nga mundësitë do të mund të ishte puna e përbashkët për ndryshimet në legjislacion dhe ndihma për ekipimin e stafit - nëpërmjet edukimit, mësimit përmes punës, trajnimit dhe profesionalizimit në vendin tonë, dhe të ngjashme.

Ombudsmani i Falimentimit në Finlandë vepron për 22 vjet

Detyra kryesore e Ombudsmanit të Falimentimit është të monitorojë aktivitetet e procedurave të falimentimit dhe të zhvillojë praktikën e duhura për administrimin e tyre. Ombudsmani i Falimentimit garanton që procedurat e falimentimit zbatohen në përputhje me ligjin dhe në përputhje me praktikën e përshtatshme të menaxhimit të pronave. Në raste të caktuara, Ombudsmani i Falimentimit mund të ndërmarrë aktivitete për të kontrolluar llogaritë dhe aktivitetet e debitorit. Ombudsmani i Falimentimit është gjithashtu përgjegjës për falimentimin-publik, i cili është një metodë për shqyrtimin e aktiviteteve para-falimentuese të debitorit.

Ombudsmani i Falimentimit ka detyrimin e përgjithshëm për të ofruar këshilla dhe udhëzime lidhur me menaxhimin e ndërmarrjeve falimentuese, si dhe për të mbikëqyrur procedurat për riorganizimin e kompanive.

Rëndësia shoqërore dhe ekonomike e falimentimit e detyroi ligjvënësin finlandez të futë mjete shtesë të kontrollit sepse nuk kishte mbikëqyrje formale nga ana e pushtetit, ndërsa kontrolli i kreditorëve konsiderohej i pamjaftueshëm.